



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce



REPUBLICA E KOSOVËS  
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS

01/01 Prot. IZLAZNI - DALËSE  
Nr. Prot. 01-02908-1286/19  
Sr. str. 1  
Nr. i fq. 1  
Datum 31.01.2019  
Data

ŠTRPCE - SHTËRPCË

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 29/01/2019 miratoi këtë :

## V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 26.12.2018

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce  
Komuna e Shtërpçës  
Municipality of Štrpce



REPUBLICA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHËTËRPCËS
IZLAZNI - DALËSE
01/01 Prot. 01-020/08-1286/19
Nr. Prot. 9
Nr. i fq. 9
Datum 31.07.2019
Data 31.07.2019
ŠTRPCE - SHËTËRPCË

## PROCESVERBAL

Nga seanca e dhjetë të rregullt e KK-ës të mbajtur më 26.12.2018, me fillim në ora 10:00

### Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së
3. Shqyrtimi dhe aprovimi të planit të punës së kuvendit për vitin 2019
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit për emërimin e rrugëve në komunën e Shtërpçës.
5. Të ndryshme.

#### 1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

**Predrag Grbic:** Të nderuari zëvendësit e kryetarit, këshilltar, drejtoret e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-ës dhe të gjithë të tjerë të pranishëm. Mirëdita dhe mirë se vini në seancën e tetë të rregullt të K.K. Shtërpçë. Në seancën e sotme janë të pranishëm të gjithë 15 këshilltarë, që do të thotë se kemi kuorum dhe mund të fillojmë me punë. A lajmërohet edhe dikush për fjalë. Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim pikë e rendit të ditës.

Konstatohet se me njëzë kemi aprovuar rendin e ditës

#### 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e KK Shtërpçë

**Predrag Grbic:** A ka dikush vërejtje në procesverbalin? Pasi nuk ka, vë në votim këtë pikë..

Konstatohet se me njëzë kemi aprovuar rendin e ditës

#### 3. Shqyrtimi dhe aprovimi të planit të punës së kuvendit për vitin 2019

**Predrag Grbic:** Në takimin e fundit, kemi formuar një komision për hartimin e Planit të punës, i cili u takua para disa ditë dhe ka bërë një propozim të tillë të Planit të Punës që ju keni marrë, dhe është e mundur që në këtë Kuvend do të bëhet ndryshimi i Planit të Punës ose të plotësimi i këtij Planit të Punës së Kuvendit. Në mbledhjen e komisionit, patëm disa sugjerime dhe ato u përfshinë në këtë Plan të Punës që keni marrë. Ky Plan mund të ndryshohet dhe nëse paraqitet një nevojë për një pikë gjatë vitit, atë here do të plotësohet.

**Rifat Rustemi:** Kur është në pyetje ky plani, ekziston një gabim teknik, gabimi është shkruar, në vend të vitit 2019, shkruan plani për vitin për 2017. Janë parashikuar 11 seanca të rregullta, dhe pauza është në gusht. Sipas meje, seanca duhet të mbahet edhe në gusht, nuk ka nevojë për pushim.

**Predrag Grbic:** Pajtohem me ju, nuk ka nevojë që gushti të jetë muaj i lirë, por ajo që është e rëndësishme është se vetëm 12 seanca mund të paguhen, për ata nuk desha të vë ndonjë pikë në Planin e Punës për muajin gusht, sepse mund të ndodh që të ketë një seancë të jashtëzakonshme deri në gusht, dhe në këtë mënyrë do ta plotësonim këtë numër prej 12 seanca që po paguhen. Nëse nuk ka ndonjë seancë të jashtëzakonshme, atëherë do të gjejmë një pikë që do të vendosim për muajin gusht. Pasi nuk lajmërohet askush, vë në votim këtë pikë.

Konstatohet se me njëzë kemi aprovua këtë pikë

#### **4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit për emërimin e rrugëve në komunën e Shtërpçës.**

**Predrag Grbic:** Do të doja të njoftoj këshilltarët se ka qenë një komision për emërimin e rrugëve dhe vendimi u mor me 2 maj 2014. Në Vendim theksohet se komisioni për emërimin e rrugëve përbëhet nga 9 anëtarë, 6 nga kuvendi komunal, 2 nga organi ekzekutiv dhe 1 përfaqësues i një fshati të caktuar, dhe qëllimi ishte që qytetarët të përfshihen në procesin e emërimit të rrugës. Kryetari i këtij komisioni ishte Aleksandar Nesic.

**Dimitrije Racicevic:** Do të shtoj se i gjithë procesi është bërë në përputhje me ligjin për sistemin e adresimit dhe bashkëpunimit me Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Pak e kemi zgjatur këtë proces, por nuk ishte faji ynë, as gabimi, por procesi në vetvete ishte i tillë që kërkonte një angazhim të tillë, dhe jo vetëm nga punëtorët e komunës por edhe nga qytetarët të komunës tonë. I gjithë procesi është përfunduar në mënyrë transparente. Nuk ka qenë e mundur për të përmbushur dëshirat personale, çdo qytetar ka dhënë një propozim për rrugë e tij, si ai donte të quhet, por ne e kemi bërë atë si ajo ishte më e përshtatshme dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e komunës tonë. Ishte e nevojshme për të gjetur 275 emra, kjo është diçka që ka qenë më e vështirë në të gjithë procesin, siç kërkohet nga ligji dhe udhëzimin administrativ nuk mund të kanë të njëjtin emër dy rrugë, edhe pse janë në pyetje vendbanime të ndryshme. Nuk ka qenë vetëm çështje emërimit e rrugëve, por edhe emërimi i shesheve, urave dhe plus ishte e nevojshme për të gjetur dhe emra rezervë, dhe është arsyeja se në qoftë se një rrugë e

urbanizohet në të ardhmen, ato emrat rezervë do të përdoret për emërtimin e atyre rrugëve. Sa i përket këtyre kodeve, këto kodet janë në sistem dhe çdo rrugë ka numrin apo kodin e saj. Ju keni këtu, në të cilën vendbanimi ndodhet dhe sa segmente përbëhen nga secili segment, sa rrugë anësore ka në atë rrugë dhe gjatësia e përgjithshme e rrugës. Unë jam këtu për t'iu përgjigjur pyetjeve nëse ka.

**Grip Sahiti:** Ne e mbështesim këtë propozim për emërtimin e rrugës dhe kemi dy propozime për ndryshimin e emrave. Në vend të Murat Imerit që të jetë Murat Dervishi dhe në vend të Idriz Xhonit të jetë Bajram Sulejmani. Kjo është kërkesa e fshatarëve të dy vendbanimeve, Iezaj dhe Xhoni. Unë kërkoj që të bëhen këto dy ndryshime.

**Rifat Rustemi:** Ne kemi pritur shumë që kjo të ndodhë, në fund kemi arritur të zgjidhim problemin e emërtimit të rrugës dhe vetëm do të doja të them se unë e mbështes këtë.

**Dimitrije Racicevic:** Pasi zëvendës së Kryesuesit ka dhënë propozimin, unë vetëm do të theksoja që nëse Kuvendi pajtohet me atë propozim për të ndryshuar këto dy emra, ajo do të hyjë në procesverbal dhe do të ndryshohet në sistem.

**Predrag Grbic:** Kjo është pikërisht ajo që kam deshtë të them drejtorë. Pasi askush më nuk lajmërohet, e qes në votim propozim për emërtimin e rrugëve, me atë se kemi dy propozime për ndryshimin e emrave të rrugëve të propozuara nga z. Garip Sahiti, kodi është 2310217, në vend të Murat Imeri duhet të jetë Murat Dervishi, dhe rruga 10220, në vend të Idriz Xhoni duhet të jetë Bajram Sulejmani. Aji është një propozim që vjen nga banoret e atyre fshatrave në të cilat do të gjenden ato rrugë.

Kush është për emërtimin e rrugës me këto ndryshime?

Konstatohet se me njëzë kemi aprovua këtë pik

## 5. Të ndryshme

**Predrag Grbic:** Para se të jap dikujt fjalë, do të doja që së pari të them diçka në lidhje me këtë pikë. Tashmë 10 ditë qytetarët e fshatit e Shtërpçës janë të shqetësuar me të drejtë se në fshatin e Shtërpçës, në vendin e quajtur "Oberek" ka përpjekje për të ndërtuar mini -hidrocentral edhe sepse është vendimi i Kuvendit që ajo hidrocentral nuk mund të ndërtohet për shkak të mungesës së ujit. Pavarësisht protestave paqësore dhe dinjitoze që janë çdo ditë po vazhdon të bëhen përpjekje për të ndërtuar këtë mini - hidrocentral. Duke marrë parasysh që përfaqësuesit e kompanisë, po janë duke u përpjekur për të vazhduar ndërtimin e kësaj mini - hidrocentral, përfaqësuesit e fshatit Shtërpçës më drejt edhe më arsye janë drejtuar Kuvendit, ku për vetëm 24 orë kanë arritur të mbledhë mbi 1.200 nënshkrime. Të unë janë ato nënshkrime me peticionin që të ndalohej punime në ndërtimin e mini-hidrocentrale. Ajo që është e rëndësishme dhe ajo që unë dua të them, ne si Kuvendi kemi marr vendimin për të ndaluar ndërtimin e mini – hidrocentrale të cilin thotë se pezullohet fillimin e ndërtimit të hidrocentrale në Shtërpçe, është

pezulluar për kohë të pacaktuar, me investitor "Matkos Grup S. P. K ". ende qëndron që shtyhet fillimi i punës deri sa të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë, si prioriteti i cili nuk është i diskutueshme për një jetë normale. Gjithashtu qëndron se vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal dhe pas publikimit në faqen e internetit të komunës së Shtërpçës. Ka një procedurë ligjore e cila është parashikuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, thuhet se Kuvendi pas vendimit është i obliguar që në MAPL e dërgon vendimin që është marrë, pastaj në MAPL është një komision që merret me kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendit. Ata janë të obliguar ta informojnë Kuvendin brenda 15 ditëve nëse vendimi që kemi marrë është në përputhje me ligjin, ose nuk është. Ne nga MAPL-ja as në afat prej 15 ditë, deri më sot nuk kemi marrë asnjë lajmërim se vendimi nuk është në përputhje me ligjin, që do të thotë se vendimi të cilin Kuvendi ka miratuar në vitin 2016, në seancën e mbajtur më 29 shtator është në fuqi. Unë jam i habitur se është e mundur që të kryen punimet, edhe pse është një vendim i Kuvendit dhe për këtë arsye një shkëlqje e një vendimi të tillë e mohon pushtetin legjislativ në komunën e Shtërpçës, dhe atëherë pyetja është se pse ekziston Kuvendi. Prandaj, ky vendim është në fuqi. Unë do të doja të lexoj një nga pjesët më të rëndësishme të letrës të cilën qytetarët e shqetësuar e komunës së Shtërpçës, ne kanë dërguar. Nuk kemi mundur vetëm këtë letrën të përcjellim këshilltareve sepse e kemi marrë në mëngjes, ashtu që nuk kemi mundur të përkthejmë në një periudhë kaq të shkurtër kohe në mënyrë që të ndajmë dhe për këshilltarët e nacionalitetit shqiptar. Peticioni është në proces dhe do të ketë më shumë nënshkrime. Letra thotë: Në qytetaret e Shtërpçës që jemi nënshkruar më post, i drejtohem kryetarit, kryetarit e KK. Shtërpçë si dhe këshilltareve e Kuvendit e KK Shtërpçë, që të ne ndihmojnë në zgjidhjen e problemit në të cilin jemi gjetur edhe cili është nga rëndësia e madhe për mbijetesë e të gjithë banorëve e Shtërpçës. Në javën e kaluar kanë filluar punime në ndërtimin e mini centralit në lumin Kalugjerica, e cila, duke shikuar nga aspekti jonë, do më thonë shkatërrimi i burimit e ujit të pijshëm i cili gjendet shumë afër vendit ku kanë filluar punime. Gjithashtu e cekim që vendbanimi Shtërpçë ka probleme me ujë, sepse rrjedhja e ujit në rezervuar e tanishëm është çrregulluar, me qëllim a po pa qëllim, me punime paraprake në fushën sportive e cila është afër burimit, është dëmtuar një krah fluksit e ujit duke përdorur makinerinë e rënd ( gropimi me bage, ngjeshje e zhavorrit dhe dridhje e rullit e rënd) për të kompozuar sasia e ujit, e cila nuk ka qenë e mjaftueshme për furnizimin e vendbanimit, ka dashur të devijohet lumi i ekzistuar në drejtimin e burimit, ashtu që deri diku është përmirësuar rrjedhja e ujit i cili ende nuk është i mjaftohem. Ajo do më thonë se uji nuk është për me pi, vetëm teknikisht, dmth. për mirëmbajtjen e pastërtisë personale, larje dhe tjera. Problemi është paraqitur të kryetari. Pe cekim, edhe mos më qenë problemi rreth ujit të pijshëm, një gjesti vandal si ky e kish prishur gjithë florë dhe faunë. Do të kishë zhdukur të gjithë botën e kafshëve nga lumi dhe gjithashtu dhe dru të cilët gjinden përgjatë lumit gjithashtu kishin terur pa ujë. Po pyetmi, a vlen gjithë kjo, që për të fituar dikush e shkatërrohet gjithë ajo natyra, duke ditur, që kapaciteti i lumit Kalugjeric nuk ka sasinë të mjaftueshme e ujit për të punuar ndonjë central, që e krijon dyshimin që krejt është me një qëllim të caktuar. Në këtë jemi të thirrur në Ligjin e Republikës së Kosovës, konkretisht së pari në Ligjin e UMNIK-ut nr. 2004/24 për ujërat e

Kosovës, ku në nenin 60 të këtij ligjit, në paragraf 60 thuhet: Konkursiumi nuk mundet të lëshohet kur më atë rrezikohet furnizimi më ujë i pijes, ekuilibër i provimit ushqimit dhe ekuilibrat të tjerat të natyrës. Në rastin ton janë to tre elemente. Rrezikohet furnizimi me ujë për pije, rrezikohet balansi e prodhimit e ushqimit sepse shumë fushat e ujit nga ky lumi dhe bujqësia kish vdekur në at pjesë, që do më tonë që përfitimi i dikujt shkon duke marr nga njëri i thjesht/ fshatar, të cilit ato fushat janë e vetmi burimi i mbijetesës. Ajo kish mund të interpretohet si rrëmbimi i pamëshirshëm dhe plaçkitje. Ju zotëri këshilltar a do të lejoni këto? Shpresoj se jo, sepse ata ju kanë zgjedhur për t'i udhëhequr ata, kur nevojitet edhe të mbron. Për ata më këtë peticion ju drejtohem kryetarit, kryesuesit e kuvendit dhe të gjithë këshilltareve e KK Shtërpçë më kërkesën që më procedurën shpejt e anulohet ajo për të cilën nënshkruesi e atëhershëm nuk kanë pasur ndenji . Gjithashtu nuk kanë qenë në denji se pe shkelin ligjin për Ujëra dmth. Ligjin nr 40/L-147 nga marsi i vitit 2013 ( i cili e ka zëvendësuar dispozitën e Ligjit për ujërat nr 2004/41) ku në nenin 1 paragraf 4 ceket: Konkursium nuk mundet të jepet kur më atë rrezikohet furnizimi më ujë i pijshëm, ekuilibër i provimit ushqimit dhe ekuilibrat të tjerat e natyrës. Gjithashtu në neni 76 për përfundimi i vlefshmërisë së lejes ujore në paragraf 1.1 thuhet: Në çdo moment kur organi kompetent shtetëror për lëshimin e lejes ujore konstaton rrezikun e kërkesës për ujë e pijshëm, në rastet urgjente, në vitet e thata, prishja e regjimit e organeve ujërave në sipërfaqe edhe nëntokësore. Gjithashtu edhe në nenin 76 paragraf 2 thuhet: Në rastin kur mungesa e ujit rrezikon në at sasi nevojën për ujë e pijshëm në rejonin e caktuar anulohet vlefshmëria e lejeve për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike, pishinat për peshqit, ambalazh e ujit, ujitje e tokës së bujqësisë. Mundet të konstatohet që në disa here është shkelur ligji për ujëra. Ju të respektojmë këshilltar duheni të vënë në dukje dhe të anuloni konsorciumin, nëse është dhënë , dhe të gjitha në bazë të ligjit. Ka dashur të lexoj këto dhe qytetarët e Shtërpçës kanë përkrahjen teme e plot në këtë proces, dhe gjithashtu kanë përkrahje e udhëheqëses së komunës së Shtërpçës. Arsye që në vitin e 2016 kemi mbajtur seancën dhe kemi marrë këtë vendim është marrëdhënie e kontraktuesit me pasurin tonë natyrale. Kemi pasur mundësi të shohim se disa here lumet gati janë pothuajse të thatë, ku disa provuesit të mjedrave ne kanë lajmëruar për të ju mundësuar ujitje, sepse uji është drejtuar në gypat. Sipas vendimit i cili u marr qëndron që ata mundin të përdorin 30% kapacitetin e ujit, shumë here po ndoll që ata e përdorin më shumë. Kapaciteti i lumit Kalugjericë është shumë i vogël së çdo devijimi e ujit mundet të krijoj një katastrofë e madhe, së pari për ekzistencën e banoreve e f. Shtërpçë, sepse nuk do të kanë ujë për pije, dhe pastaj mund të rrezikon sistemin ekologjik, bimëve edhe kafshëve. Kjo duhet të merret shumë seriozisht. Unë tani do të drejtohem qytetarëve dhe ti tregoj atyre: Ne kemi këtë peticion dhe letrën kemi marr në këtë mëngjes, duke biseduar me udhëheqësit, jemi marrë veshë që sot ne nuk mund të marrim vendim, për shkak se aji mund të ketë të nxituar, ndoshta kish qenë në kundërshtim me ndonjë ligj. Ajo që është të rëndësishme se njerëzit nga udhëheqësja menjëherë pas Kuvendit do të kontaktojnë avokatët dhe do të punojnë së bashku me ta për këtë dhe të përdorin në këto argumente që ne kemi. Nga unë aq shumë dhe unë shpresoj se edhe dikush tjetër do të përfshihet në diskutim, sepse kjo është shumë e rëndësishme, në pyetje është mbijetesja jonë.

**Grip Sahiti:** Të gjithë, ka shqetësim rreth ndërtimit të këtyre hidrocentraleve, si të serbët ashtu edhe të shqiptarët. Vendimi i Kuvendit nuk respektohet. Fitimet janë shumë minimale duke marrë parasysh të gjitha pasojat që mund të kemi nga kjo. Ne duhet të punojmë në interes të qytetarëve, jo në interes të individëve që kanë dobi nga ndërtimit të këtyre hidrocentraleve. Lepenac është degraduar në një masë të madhe, kjo është e qartë dhe ky është një problem i madh. Unë mbështes qytetarët për këtë.

**Predrag Grbic:** Kam harruar të them se, nëse është e nevojshme, kjo pika do t'i kthehet Kuvendit për shqyrtim.

**Rifat Rustemi:** Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe është shumë shqetësuese për qytetarët e Shtërpcës, unë jam për të mbrojt interesat e qytetarëve sa më shumë që të jetë e mundur. Kuvendi ka dashur që të bëjë një analizë të detajuar dhe pastaj me dhënë leje për ndërtimin e këtyre mini - hidrocentraleve. Ka dashur të bëhet analiza e fitimit dhe dëmit. Nuk dashur të japim fare këtë leje për ndërtimin e këtyre hidrocentraleve, mendoj për tërë komunën e Shtërpcës. Natyra po dëmtohet, dhe është e nevojshme të bëhet një analizë dhe të diskutohet për këtë dhe për të merren disa përfundime. Tani nuk mund të ndalojmë, pasi që licenca tashmë ekziston, dhe kompania mund të ketë investuar tashmë miliona, dhe kjo i komplikon gjërat edhe më shumë, dhe kompania mund të na padisë. Edhe komuna të paguan 10 vjet dëmshpërblimin.

**Predrag Grbic:** Që keni thënë se ata kanë filluar të punojnë. Akti më i lartë një vendi është Kushtetuta, në qoftë se është e mundur për të ndryshuar Kushtetutën, pse nuk mund të ndryshohet vendimi i cili u marr atë here, sepse atëherë kur është marr ai vendim, Kuvendi ka kërkuar që të përmbushen shumë parakushtet. Së pari, mbrojtja e mjedisit, për të parandaluar ndotjen, për të shfrytëzuar 30% të kapacitetit të ujit, mos me prishin pamjen e mjedisit dhe më e rëndësishmja ata kanë dashur të marrin licencat nga disa ministri dhe atë me standarde evropiane. Në fillim, të gjitha janë dukur fantastike, por kur ka vazhduar, ne kemi kuptuar se është bërë një gabim dhe pasi ata nuk i përmbahen asaj që kanë pranua sipas vendimit e Kuvendit atëherë, dhe atyre që nuk qëndrojnë në ato licenca që kanë marrë, atëherë të vërtetë është koha për alarm, për të ndaluar ndërtimin e mini - hidrocentraleve. Ky është një problem i madh, sepse ne tani kemi një problem me ujë, dhe çfarë do të kish ndodhur në qoftë se ndërtohen mini - hidrocentralet dhe më e rëndësishmja, ne kemi në plan për të ndërtuar një fabrikë për pastrimin e ujit, dhe nëse ata i kishin ndërtuar at mini-hidrocentralin, nuk do të këtë ujë mjaftueshëm për fabrikën dhe nuk do të mundën banorët e Shtërpcës të marrë ujë të pijshëm të pastër. Unë e pranoj propozimin tuaj që të gjitha detajet në lidhje me këtë të shqyrtuar përsëri nëse ka nevojë

**Sasa Krstic:** Unë absolutisht e mbështes iniciativën që ka ardhur nga qytetarët e Shtërpcës dhe të gjithë Zhupës së Sirinjës. Me protesta paqësore është e domosdoshme të pengohet puna në ndërtimin e këtyre mini-hidrocentraleve pasi kjo do të rrezikojë në mënyrë drastike furnizimin me ujë të pijshëm të shëndetshëm në komunën e Shtërpcës dhe me siguri do të ndikojë në të gjithë botën e gjallë në këto lumenj, kështu që edhe nga pikëpamja ekologjike është krejtësisht e

pajustificuar dhe fitimi në energji elektrike është shumë e vegël, vetëm ajo kompani private do të përfitonte nga ajo. Ne si anëtarë të Kuvendit duhet ta mbështesim këtë nismë dhe qytetarët e komunës së Shtërpcës.

**Predrag Grbic:** Duke nënshkruar këtë peticion, ne japim mbështetje dhe ne do të vazhdojmë të punojmë në konsultim me avokatët tanë dhe do të ndërmarrim hapat të nevojshme.

**Rifat Rustemi:** Kam tre çështje të ndryshme. Para është lidhur më zyrën për komunitete dhe kthim, unë një here kam kërkuar që një raport e sillet në kuvendin nga ju, që zyra e raporton Ministrisë dhe Qeveri në at kohë nuk e kam lexuar ligjin mirë, ndërkohë kam lexuar ligjin edhe së e kam ditur që duhet më raportua në kuvendin edhe kryetarin, por unë e kam lexuar një ligj këtu i cili ka të bëjë më zyrën për komunitet dhe kthim, rregullore nr.02/30 për zyrat komunale për komunitet edhe kthim, 117 detyrat dhe përgjegjësi e zyrës pika 1.7 thotë: mbikëqyr dhe e dorëzon raportet të rregullta kryetarit e komunës edhe kuvendit komunal dhe institucioneve e qeveris qendrore, për progresin e arritur për të drejtave e komuniteteve, qasje e tyre parapare në shërbime komunale, kthim, riadresim dhe ritregim dmth. sipas kësaj rregullores zyra për komunitet dhe kthim është e obligime që të raporton kryetarit gjithsesi edhe kuvendit edhe institucioneve qendrore. Problemi është kështu: zyra komunale për komunitete dhe kthim me materialin që shpërndan vazhdimisht nuk e përfill kriteret, atë thuhet për riadresim për kthim, marinë material njerëzit që janë zyrtar e komunës ka zyrtar e policisë së Kosovës edhe tjerë zyrtar, përgjithësi janë zyrtar e komunës që marrin material. Shtrohet pyetja a ka dal dikush me pa familje, ka familje varfër të cilëve shpija i marrojnë shoqata siç është „Jetimet e Ballkanit” edhe shoqatat tjera që marrojnë shpija banoreve e komunës së Shtërpcës, edhe ju blejnë banesat a komuna e jep material zyrtareve e komunës. Edhe ma tepër, kur aji material nuk shfrytëzohet për më ndërtua shtëpi por shitet, ose e ndan me njanjë zyrtar e komunës që ja miraton materialin përgjumem, nuk di ku është problemi, është tu keqpërdor më të madhe sa i përket materialit ndërtimor. Kisha kërkuar nga zëvendësi i kryetari për komunitete më ma dhënë një përgjigje, a është e vërtet kjo që po them unë a po jam tu shpif, sepse unë nuk e kam informata e dorës së par, unë po shoh që materiali po shkon edhe në Ferizaj edhe gjithkund. Po bartet nga Shtërpcë shkon në Ferizaj, po jetë materiali neper fusha, livadhe edhe e shesin, nëse kushton 5 € e shet 2€, edhe kisha pas dëshirë që me pas një kujdes veçanet edhe më na pru raportin. këtu në Kuvend ose më na mundësuar të shkojmë në zyre edhe më pa. E dyta , pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, çështja e varrezave, kemi pasur këto në janar ose shkurt drejtori ka thonë që do të fillon edhe në fakt ka filluar dikur në maj, nëse nuk gabo, në f.Brod ata punëtor kanë punuar vetëm dy orë një dy varreza kanë punuar dhe kanë shkuar, gjysma e varrezave nuk janë heq rrethuar, a është më tender a si u dhënë kjo punë nuk di. Kompania më siguri i ka marr pare a nuk ka punuar si duhet. Treta është mbikëqyrja e projekteve, janë tu caktuar zyrtar e komunës që të pranojnë punime, e pranojnë shkel e shko, punë nuk kruhen, pagesa bëhet, kush e paguan? taksapaguesi i komunës së Shtërpcës.

**Radojka Repinovic:** Dua të shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë për kontributin e tyre në funksionimin e suksesshëm e komunës gjatë vitit të kaluar. Unë dua të gjithë të uroj Vitin e Ri dhe festat e Krishtlindjeve dhe neve dëshiroj që kemi sukses në punës në vitin e ardhshëm.

**Predrag Gbic:** Ju keni përmendur se detyra e zyrës që është këtu, është të japë raporte të rregullta kryetarit të komunës dhe Kuvendit, dhe kjo po ndodh. z. Rifat. Kemi dy raporte të rregullta të punës së kryetarit të komunës dhe në këtë raport, përveç raporteve të drejtorive të tjera që funksionojnë në komunën tonë, është eshtë raport nga zyra për kthim.

**Fikri Hasani:**Unë e falënderoj z. Rifatin për pyetje që më ka bërë, unë personalisht si përfaqësuesi i komunitetit shqiptar jam dal në terren, i kam identifikuar familje që kanë nevojë për ekzistencën sociale edhe për material ndërtimor, kam bërë një listë edhe e kam dhënë komisionit të cili është kompetent për dhënien edhe shpërndarjen e ati materialit, informata që i ka sjell z.Rifati këtu në Kuvend nuk e di sa janë të sakta por nëse janë sakta, këtu del që përfitojnë zyrtar komunal, unë personalisht, ose kush qoftë, atëherë edhe nuk është e drejta, ne jemi këtu si përfaqësuesit e komunitetit edhe nuk jemi këtu për të përfaqësuar vetin dhe të përfitojmë na. Unë e kam informuar komisionin që me marr masa edhe deri tani nuk e kam marr një përgjigje e tillë, edhe kam ardhur në përfundim që shpërndarja e materialit ndërtimor është sikur dhurata e babadimërit, babadimër nuk zgjedh familje ose fëmijë, cilit më dhënë, por që e she një fëmijë ja jep dhuratën . Ndoshta edhe këtu materiali është dhurata e babadimërit kush donë, si donë pa kritere. Unë e di që deri qetash dikush që nuk e ka plotësuar kritere nuk e ka marr material. Tash e shohim ne, se a kanë marrë zyrtar e komunës jon, organet kompetente duhen të mirën më ata që keq përdorin materialin. Edhe nëse Rifati ka argumente not i njofton organet edhe atëherë not veprojnë organet edhe drejtësia.

**Predrag Grbic:** Ajo që di për këtë shpërndarje të materialeve është se ka një komision për këtë dhe aji i viziton shtëpitë dhe në bazë të disa prioriteteve, shpërndan materialin për ata që kanë nevojë për atë. Tregime të ndryshme qarkullojnë rreth gjërave të ndryshme, por nuk është për mua ta zgjidhë atë, ka kush përgjegjës për këtë

**Sinisa Buduric:** Projekti për mirëmbajtjen e varrezave ishte pjesë e projektit për mirëmbajtjen verore të rrugëve lokale. Nuk është e vërtetë që kompania ka punuar vetëm dy orë, kanë punuar për 15 ditë. Ekziston një menaxher i projektit në pjesën shqiptareve, ka të gjitha raportet, projekti është thirrur deri më 21 nëntor, ka zgjatur 9 muaj. Pjesa më e madhe e projektit shkoi në mirëmbajtjen e rrugëve verore. Ne do të vazhdojmë me projektet të reja vitin e ardhshëm, diku nga muaj marsi.

**Rifat Rustemi:** Sa për mirëmbajtjen e rrugëve është e vërtet, është investuar në mirëmbajtjen e rrugëve, sepse ka pasur reshje atmosferike edhe terreni gjeografik e komunës është asi soji. Edhe një pyetje për drejtorin e urbanizmit, pse nuk asfaltohen rrugët më shpejt për mos me pasur investime kota, sepse po bëhet një zgjidhje për një përudh e shkurt edhe apët kthehet ajo gjendja e cila ka qenë edhe përpara. Sa për mirëmbajtjen e varrezave jam dëshmitar që nuk janë tu

mirëmbajtur varrezat, kanë shkuar neper varreza, kanë punuar ka një or, një or e gjysma, ka dëshmitar, edhe mundeni më erdh edhe me u bind. Shkoni në f. Brod dhe f. Firaja, për fshatrat e serbe nuk di, edhe nuk mund të foli për ata. Shkoni edhe besedoni me qytetaret që banojnë përball varrezave edhe e pyetni a ka punuar dikush.

**Fikri Hasani:** Sa për çështje e pastrimit e varrezave në pjesën shqiptareve, unë edhe në bordin e drejtorëve kam folur me drejtorin, puna që ka filluar nuk ka përfunduar fare, atë i kanë dërguar dy punëtor, kanë punuar një ditë dy, edhe varrezat nuk janë pastruar, not drejtori e dëshmon që një projekt i tillë ka përfunduar me sukses unë them që jo. Arsye qëndron atë, së dru që janë atë, atë nuk mund të ritën për dy ose tre ditë. Kam dal në terren, kam vizituar të gjitha varrezat. Operatori që ka pas të punoj, nuk e ka përfunduar punën, organi i mbikëqyrës nëse ja ka pranuar punën, atëherë është përgjegjësia e tyre që i ka pranuar punën. Unë edhe një herë kisha bërë ftes drejtorit me dal në terren dhe ta viziton varreza edhe të she se puna nuk është kryer, që ka dashur të kryhet

**Predrag Grbic:** Pasi nuk lajmërohet askush , seanca e sotshme ka përfunduar

**Procesmbajtësi**  
**Staja Markovic**

---

